

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS:

“Blerje pajisje të teknologjisë së lartë për spitalet”, ndarë në 10 lote - Marrëveshje Kuadër me disa operatorë ekonomik (një OE të vetëm të suksesshëm për sejcilin lot)- ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara - me afat 36 muaj” me fond limit/vlera e pritshme e kontratave në total prej 259,380,166 (dyqind e pesëdhjetë e nëntë milion e treqind e tetëdhjetë mijë e njëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë) Lekë pa TVSH.

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

Pajisje mjekesore: 33100000-1

VLERA E FONDIT LIMIT: në total prej 259,380,166 (dyqind e pesëdhjetë e nëntë milion e treqind e tetëdhjetë mijë e njëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë) Lekë pa TVSH, ndare në lote:

- **Lot1 - Aparat Anestezie** me fond limit/vlera e pritshme e kontratave 12,266,120 (dymbëdhjetë milion e dyqind e gjashtëdhjetë e gjashtë mijë e njëqind e njëzet) lekë pa TVSH, fondi limit ne euro 122,429 Euro pa TVSH.
- **Lot2 - Respirator** me fond limit/vlera e pritshme e kontratave 2,093,520 (dy milion e nëntëdhjetë e tre mijë e pesëqind e njëzet) lekë pa TVSH, fondi limit ne euro 20,895 Euro pa TVSH.
- **Lot3 - Grafi-skopi stacionar digjital** me fond limit/vlera e pritshme e kontratave 32,018,133 (tridhjetë e dy milion e tetëmbëdhjetë mijë e njëqind e tridhjetë e tre) lekë pa TVSH, fondi limit ne euro 319,574 Euro pa TVSH.
- **Lot4 Echo 3D/4D me aplikim te pergjithshem + sonde lineare + sonde kardiake + sonde konvekse + sonde gjinekologjike** me fond limit/vlera e pritshme e kontratave 37,356,570 (tridhjetë e shtatë milion e treqind e pesëdhjetë e gjashtë mijë e pesëqind e shtatëdhjetë) lekë pa TVSH, fondi limit ne euro 372,857 Euro pa TVSH.
- **Lot5 Sistem komplet fibrobronkoskop** me fond limit/vlera e pritshme e kontratave 13,266,667 (trembëdhjetë milion e dyqind e gjashtëdhjetë e gjashtë mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e shtatë) lekë pa TVSH, fondi limit ne euro 132,415 Euro pa TVSH.
- **Lot6 Grafi portabel digjitale** me fond limit/vlera e pritshme e kontratave 7,870,950 (shtatë milion e tetëqind e shtatëdhjetë mijë e nëntëqind e pesëdhjetë) lekë pa TVSH, fondi limit ne euro 78,560 Euro pa TVSH.
- **Lot7 Sistem komplet Laparaskopi** me fond limit/vlera e pritshme e kontratave 12,006,800 (dymbëdhjetë milion e gjashtë mijë e tetëqind) lekë pa TVSH, fondi limit ne euro 119,840 Euro pa TVSH.
- **Lot8 Sistem komplet artroskopie** me fond limit/vlera e pritshme e kontratave 9,896,867 (nëntë milion e tetëqind e nëntëdhjetë e gjashtë mijë e tetëqind e gjashtëdhjetë e shtatë) lekë pa TVSH, fondi limit ne euro 98,781 Euro pa TVSH.

- **Lot9 Mamografi Digjitale** me fond limit/vlera e pritshme e kontratave 15,191,873 (pesëmbëdhjetë milion e njëqind e nëntëdhjetë e një mijë e tetëqind e shtatëdhjetë e tre) lekë pa TVSH, fondi limit ne euro 151,631 Euro pa TVSH.
- **Lot10 CT Scan 64 slice** me fond limit/vlera e pritshme e kontratave 117,412,667 (njëqind e shtatëmbëdhjetë milion e katërqind e dymbëdhjetë mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e shtatë) lekë pa TVSH, fondi limit ne euro 1,171,900 Euro pa TVSH.

Fondi limit/vlera e pritshme e kontratave i konvertuar ne euro sipas kursit zyrtar te Bankes se Shqiperise date **06/08/2024: 2,588,882** Euro pa TVSH.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit Nr.162/2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar, autoriteti/enti kontraktor/OQB **Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale** ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT - të njëjta për të gjitha lotet

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

- a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8*
- b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar,.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):
(nuk është i aplikueshëm)

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 40, pika 5, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 ”Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar,, si dhe nenit

.....
(Shënim: përcaktoni **nëse është rasti**, aktin konkret ligjor ose nënligjor që parashikon plotësimin e ndonjë kërkesë specifike për ushtrimin e veprimtarisë profesionale që lidhet me objektin e prokurimit). **(nuk është i aplikueshëm)NA**

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare **2021, 2022, 2023**, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë

jo më e vogël se 40% e fondit limit/vlera e pritshme e kontratave të lotit apo shumës së loteve për te cilat oferton sipas tabelës së mëposhtme. (Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur nëse Operatori ekonomik arrin vlerën e xhiros minimale në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga Autoriteti Kontraktor).

Nr	Lot/Emërtimi i pajisjes	Njesia	Sasia	Vlera e pritshme	Xhiro/Kontrata e ngjashme (lek)	Xhiro/Kontrata e ngjashme (euro)
1	Lot.1 Aparat Anestezie	cope	4	12,266,120	4,906,448	48,971
2	Lot2 Respirator	cope	1	2,093,520	837,408	8,358
3	Lot3 Grafi-skopi stacionar digjital	cope	2	32,018,133	12,807,253	127,830
4	Lot4 Echo 3D/4D me aplikim te pergjithshem + sonde lineare + sonde kardiake + sonde konvekse + sonde gjinekologjike	cope	9	37,356,570	14,942,628	149,143
5	Lot5 Sistem komplet fibrobronkoskop	cope	2	13,266,667	5,306,667	52,966
6	Lot6 Grafi portabel digjitale	cope	1	7,870,950	3,148,380	31,424
7	Lot7 Sistem komplet Laparaskopi	cope	1	12,006,800	4,802,720	47,936
8	Lot8 Sistem komplet artroskopie	cope	1	9,896,867	3,958,747	39,512
9	Lot9 Mamografi Digjitale	cope	1	15,191,873	6,076,749	60,652
10	Lot10 CT Scan 64 slice	cope	2	117,412,667	46,965,067	468,760

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Bazuar në nenin 43 pika 2/a, 43 pika 3 dhe 43 pika 5 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, ku përcaktohet:

Neni 43 pika 2/a

Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë:

b) dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës, në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar.

Neni 43 pika 3

Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

Neni 43 pika 5

Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale, llogaritet mbi bazën e vlerës maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër.

Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e xhiros që mund të kërkohet, autoritetet/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të xhiros brenda këtij marzhi.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në nenin 29, te Ligjit Nr. 29/2023 "Për Tatimin mbi të Ardhurat" i ndryshuar, ku përcaktohet: Deklarata tatimore vjetore dorëzohet në organin tatimor jo më vonë se data 31 mars e vitit pasardhës të vitit tatimor për të cilin dorëzohet deklarata.

Vlerësojmë se vërtetimin për xhiron vjetore të certifikuar të vitit 2023, operatorët ekonomikë mund ta disponojnë pas paraqitjes së deklaratës vjetore në organet tatimore, për të cilën kanë afat deri më 31.03.2024.

(Shënim: citoni dispozitën përkatëse të legjislacionit tatimor, ku përcaktohen afatet për paraqitjen nga tatimpaguesit të deklaratës vjetore pranë organeve tatimore).

2.2.2. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare _____, të shoqëruara me Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabel te Autorizuar, vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të ... *(shëno bazën ligjore)*, ku bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme, nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivit.

(nuk është i aplikueshëm)NA

(Shënim: ky kriter vendoset vetëm në rastet kur vlerësohet nga autoriteti/enti kontraktor)

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" të ndryshuar,.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, _____

*(Shënim: citoni dispozitën përkatëse të legjislacionit tatimor, ku përcaktohen rastet kur personat juridikë kanë detyrimin që të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikimit të tyre, nga eksperte kontabël ose shoqëri audituese). **(nuk është i aplikueshëm)***

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 40 % të vlerës së fondit të limit të lotit apo shumatores së fondit limit të loteve për të cilat oferton, sipas tabelës në pikën 2.2.1.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara,
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar dhe nenit 40, pika 4, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 40% të vlerës së fondit limit të lotit /apo shumatores së loteve që oferton, vlerë e cila është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë dhe është në përputhje me përcaktimet e RRPP neni 40 pika 4:

“4. Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Në çdo rast, vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 40% të vlerës së përlllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Autoriteti/enti kontraktor si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.”

Është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën sa 40% të fondit limit/(vlerës së pritshme të kontratave) të lotit apo shumës së loteve për të cilat oferton

operatori, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar (jo më të madhe se 40% të vlerës së përllogaritur të kontratës).

Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e kontratave të ngjashme që mund të kërkohet, autoritete/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të kontratave të ngjashme brenda këtij marzhi.

Shënim: Autoriteti /enti kontraktor mund të kërkojë edhe:

2.3. Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim

2.4.1

(Shënim: Autoriteti/enti kontraktor, në varësi të natyrës së objektit të prokurimit, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës, duke argumentuar teknikisht dhe ligjërisht çdo kriter, duke përcaktuar, sipas rastit, aktin ligjor/nënligjor që parashikon domosdoshmërinë e kriterit në fjalë).

3. Operatori ekonomik duhet të vetëdeklarojë origjinën e mallit dhe kompaninë prodhuese (të plotësohet në shtojcën 2 të DST).

Argumentimi: Ky kriter vendoset me qëllim njohjen e origjinës së mallit dhe kompaninë prodhuese për të identifikuar në mënyrë të qartë atë gjatë lëvrimit të tij dhe për të pasur sigurinë që i njëjti mall i ofertuar do të lëvrohet në destinacion ne perputhje me nenin 40, pika 8, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar, dhe keto kërkesa i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e mundësisë së OE për përmbushjen me sukses te kontrates pra te garancise se furnizimit te mallit objekt prokurimi si dhe lidhen me :

1. Cilësinë dhe besueshmëria e Pajisjeve: Kjo siguron që pajisjet janë të cilësisë së lartë dhe të besueshme për përdorim mjekësor.

2. Certifikimet dhe Standardet: Pajisje mjekësore duhet të jenë të certifikuara sipas standardeve ndërkombëtare si ISO, CE, apo FDA. Këto certifikime shpesh jepen bazuar në praktikat e kompanisë prodhuese.

3. Garancia dhe Mbështetja Teknike/mirëmbajtja: Kompanitë prodhuese ofrojnë garanci dhe mbështetje teknike për pajisjet e tyre, që është kritike për mirëmbajtjen dhe riparimin e pajisjeve mjekësore më tej gjatë fazës së përdorimit të tyre.

4. Përputhshmëria me legjislacionin ne fuqi: Pajisjet mjekësore duhet të përputhen me Ligjin shqiptar për pajisjet mjekësore. Informacioni mbi kompaninë prodhuese ndihmon për të verifikuar përputhshmërinë.

5. Informacioni mbi kompaninë prodhuese mund të japë detaje mbi historinë e produkteve të mëparshme dhe suksesin e tyre në treg.

Kërkimi i informacionit për kompaninë prodhuese në një tender për pajisje mjekësore ndihmon në sigurimin e pajisjeve të sigurta, të besueshme dhe të përputhshme me standardet dhe ligjin e aplikueshem

4. Operatori ekonomik duhet të paraqesë Certifikatë ISO 9001:2015 /ose/ ekuivalent, ose ISO 13485 "Për Sistemin e menaxhimit të cilësisë për pajisjet mjekësore", /ose ekuivalent/, të vlefshme, për prodhuesin/distributorin zyrtar të autorizuar nga prodhuesi, në përputhje me objektin e prokurimit. Certifikata të jetë leshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Argumentimi: Ky kriter vendoset në përputhje me piken 1 te nenit 79 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" te ndryshuar dhe nenin 44 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" te ndryshuar, lidhur me dëshmitë për rezultatet e testimeve zyrtare të lëshuara nga institucione të autorizuar që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike. Ky kriter është i lidhur ngushtë me objektin e kësaj kontrate si dhe me aftësinë zbatuese të kontratës, me garantimin e kapaciteteve profesionale dhe të cilësisë nga OE pjesëmarrës.

Kërkohet certifikim i prodhuesit ose vetëdeklarimi për të provuar se mallrat e ofertuara plotësojnë kërkesat e cilësisë sipas përcaktimit të pikës 1 te nenit 79 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" ku përcaktohet se: *Autoriteti ose enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t'u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Kjo dispozitë zbatohet edhe kur kërkesat teknike u referohen kualifikimeve të kandidatit ose të ofertuesit.*

Duke qënë se bëhet fjalë për pajisje mjekësore të cilat nuk janë mallra të zakonshme konsumi, por mallra të cilat lidhen direkt dhe kanë ndikim në shëndetin e pacientëve, AK kërkon që malli të plotësojë kërkesat e cilësisë, në mënyrë që malli të jetë sa më i sigurtë nga pikëpamja e kushteve të prodhimit. Certifikimi ISO i prodhuesit është një kriter i cili është kërkuar historikisht nga AK për procedura prokurimi të ngjashme për pajisje mjekësore.

Vendosja e këtij kriteri nuk çënon kushtet e konkurrencës së lirë dhe nuk përbën diskriminim apo vështirësi për OE të cilët merren me tregtimin e këtij lloji malli (i cili rregullohet specifikisht nga Ligji për pajisjet mjekësore) dhe nga ana tjetër garanton sigurinë e produktit që ofrohet.

Gjithashtu duke qënë se bëhet fjalë për mallra që nuk gjenden lehtësisht në treg, kërkohet që të garantohet edhe lidhja mes furnitorit dhe prodhuesit, pasi duke mos patur mekanizma që ngarkojnë me përgjegjësi tregtarin e thjeshtë si në vendet e BE-së, ky kusht është një garanci më tepër për AK për furnizimin me mallra konform standarteve në fuqi.

Me vendosjen e këtij kriteri AK arrin të identifikojë apo vërtetojë prodhuesin e vërtetë të mallit dhe sigurohet nga organizma të ndërkombëtarë/kombëtarë nëse ky mall realisht i plotëson kushtet e menaxhimit të cilësisë së prodhimit.

5. Ofertuesi duhet të jetë i certifikuar ISO 9001:2015/ose/ ekuivalent, objekti i së cilës t'i përkasë fushës së aktivitetit të OE. Për këtë ai duhet të paraqesë certifikatën përkatëse, të vlefshme. Certifikata të jetë lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Argumentim: Ky kriter vihet në përputhje me pikën 6/c të nenit 40 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar, lidhur me dëshmitë për rezultatet e testimeve zyrtare të lëshuara nga institucione të autorizuara që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike si dhe rekomandimit të APP nr. 3341/1 datë 20.03.2018 “Mbi hartimin e kriterëve për kualifikim në DT të procedurave të prokurimit”. Certifikimi është obligator në zbatim të Ligjit 89/2014 “Për pajisjet mjekësore” të ndryshuar (nenit 17 dhe 18), pasi keto pajisje standartizohen dhe regjistrohen si pajisje mjekësore.

Duke patur parasysh se pajisjet mjekësore të teknologjisë së lartë janë pajisje që nuk gjenden lehtësisht në treg dhe nuk prodhohet në Shqipëri, OE të interesuar për procedurën në fjalë duhet që patjetër të jenë të i certifikuar për import/eksport/tregtim të pajisjeve objekt prokurimi.

6. Operatori ekonomik duhet të paraqesë Certifikate konformiteti CE sipas direktivës MDD 93/42 EEC ose MDR (EU) 2017/745, të përditësuara, për të gjithë artikujt e ofruar, sipas kategorizimit të tyre, ose certifikate FDA.

Argumentim: Ky kriter vendoset në përputhje me pikën 3 dhe 6/c të nenit 40 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar, lidhur me dëshmitë për rezultatet e testimeve zyrtare të lëshuara nga institucione të autorizuara që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike. Certifikimi CE sipas direktivës ose rregullores europiane për pajisjet mjekësore, ose certifikimi FDA i këtyre materialeve është obligator në zbatim të Ligjit 89/2014 “Për pajisjet mjekësore”, të ndryshuar (nenit 17 dhe 18) si dhe rekomandimit të APP nr. 3341/1 datë 20.03.2018 “Mbi hartimin e kriterëve për kualifikim në DT të procedurave të prokurimit”.

7. Operatori ekonomik duhet të paraqesë autorizim nga prodhuesi i mallrave ose nga distributori i autorizuar nga prodhuesi, ku në rast të dokumentohet lidhja e distributorit me prodhuesin, për lejimin e tregëtimit të artikujve të tij.

Argumentim: Ky kriter vendoset me qëllim njohjen e origjinës së mallit dhe kompaninë prodhuese për të identifikuar në mënyrë të qartë atë gjatë lëvrimin të tij dhe për të pasur sigurinë që i njëjti mall i ofruar do të lëvrohet në destinacion në përputhje me nenin 40, pika 8, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar, dhe keto kërkesa i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e mundësisë së OE për përmbushjen me sukses të kontratës pra të garancisë së furnizimit të mallit objekt prokurimi.

8. Operatori duhet të paraqesë “Autorizim për tregtim të pajisjeve mjekësore”, të lëshuar nga MSHMS sipas Ligjit 89/2014 “Për pajisjet mjekësore”.

Argumentim: Ky kriter vihet në përputhje me nenin 21 “Autorizim per tregtim te pajisjeve mjekesore” i Ligjit 89/2014 “Për pajisjet mjekësore”.

9. Kërkojen të paraqiten katalogë teknike për artikujt e ofertuar ku të jenë të pasqyruara specifikimet teknike të kërkuara. Në katalogë, duhet të markohen me ngjyrë të ndezur (të verdhë), specifikimet teknike sipas DST. (Katalogët duhet të ngarkohen në www.app.gov.al së bashku me dokumentacionin e kërkuar në këto DT. Përshkrimi teknik duhet të jetë në gjuhën shqipe ose anglisht).

Argumentim: Ky kriter vendoset në përputhje me pikën 6/b të nenit 40 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar, lidhur me dëshmitë për fotografitë ose katalogët teknike, me qëllim verifikimin e plotesimit të specifikimeve teknike.

10. Deklarate per permbushjen e afatit te garancise. Kërkohet minimumi 2 vjet garanci, perfshirë blerjen dhe zëvendesimin e pjeseve te difektuara me pjese kembimi te reja dhe origjinale.

Argumentimi: Ky kriter vendoset në përputhje me nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe pikën 3 të nenin 40 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar. Ky kriter është i lidhur ngushtë me objektin e kesaj kontrate si dhe me aftesine zbatuese te kontrates, me garantimin e kapaciteteve teknike dhe profesionale nga OE pjesemarres.

11. Vetëdeklaratë:

- Oë merr përsipër trajnimin e dy personave nga stafi përdorues për cdo pajisje.

- Per furnizimin sipas kërkesës se AK, me pajisje te reja, sipas prodhuesit te deklaruar ne oferte.

- Për përmbushjen e afatit të garancisë sipas përcaktimeve në specifikimet teknike të DST.

- Oë merr përsipër të kryejë shërbimin e transportit, montimit si dhe vendosjen nëpër vende të të gjithë artikujve në vendin e dorëzimit.

Argumentimi: Ky kriter vendoset në përputhje me nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe pikën 3 të nenin 40 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar,. Ky kriter është i lidhur ngushtë me objektin e kesaj kontrate si dhe me aftesine zbatuese te kontrates, me garantimin e kapaciteteve teknike dhe profesionale nga OE pjesemarres.

12. Ofertuesi duhet te kete ne stafin e tij inxhinier/ë:

inxhinier biomedikal ose elektronik ose informatik ose elektrik te trajnuar per pajisjen/t objekt prokurimi për të cilën/at oferton.

Per kete duhet te paraqese:

- Diplomen perkatese

- CV

- Kontrate pune

- Certifikata/ose deshmi trajnimi te tyre për pajisjen/t objekt prokurimi për të cilën/at oferton.

Kriteri konsiderohet i përmbushur me paraqitjen e formularit të vetëdeklarimit sipas shtojcës 8 të DST.

Shenim:

Referuar pikës 1, të nenit 26, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, i ndryshuar, ku parashikohet : “*Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla*”, si dhe përcaktimet e pikës 6, të këtij neni, ku parashikohet: “*Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin*”.

Argumentimi: Ky kriter vendoset në përputhje me nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe pikën 3 të nenin 40 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar. Ky kriter është i lidhur ngushtë me objektin e kesaj kontrate si dhe me aftesine zbatuese te kontrates, me garantimin e kapaciteteve teknike dhe profesionale nga OE pjesemarres. OE duhet te kete ne stafin e tij inxhiniere te cilet duhet te jene te trajnuar per pajisjet objekt i lotit apo loteve per te cilat oferton. OE mund te disponoje nje ose disa inxhiniere secili prej te cileve te jete i trajnuar per nje ose me shume pajisje apo grup pajisjesh objekt i kesaj procedure.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

SPECIFIKIME TEKNIKE

- Specifikimet teknike të pajisjeve janë specifikimet minimale që duhet të plotësojnë këto pajisje. Janë të mirëpritura pajisje me specifikime më të mira.
- Të gjitha pajisjet duhet të jenë të certifikuara CE/FDA
- Të gjitha pajisjet e mëposhtme mjekësore, pjesët përbërëse dhe aksesoret e tyre duhet të jenë të reja, të prodhuara jo më shumë se 1 (një) vit më parë
- Të gjithë pajisjet duhet të shoqërohen me të gjithë informacionin e nevojshëm si broshura, manuale përdorimi, manual teknikë, etj
- Për të gjitha pajisjet duhet të kryhen trajnimet përkatëse për përdorimin e tyre
- Garancia e pajisjeve të jetë jo më pak se 1(një) vit

1 Aparat Anestezie

Të jetë e aplikueshme mbi pacientët: pediatrik, adult.

Të jetë e lëvizshme, e pajisur me 4 (katër) rrota ku të paktën 2 (dy) prej tyre të jenë me mekanizëm

frenimi.

Të jetë e pajisur me të paktën 2 (dy) sirtarë.

Të ketë panel me ekran me prekje (touch screen) me ngjyra me përmasë jo më pak se 8”.

Të jetë i pajisur me sistem me 3 (tre) gaze mjekësorë, O₂, N₂O dhe Ajër dhe të jetë e kontrolluar me ventilator në mënyrë elektronike.

Të jetë e pajisur me kontrollues fluksi për secilin gaz me mundësi rregullimi në intervalet nga 0 deri në jo më pak se 10 L /min.

Matja e oksigjenit të jetë 100% me saktësi prej ± 3 vol % nëpërmjet sensorit.

Të shoqërohet me kapacitetin e dedikuar dhe të pavarur për lidhje me kanulën nazale në lidhje me përqendrimin O₂ me kontroll të rrjedhjes deri në jo më pak se 10 L / min.

Të jetë e pajisur me mekanizëm sigurie për përzierje O₂/N₂O në një vlerë minimale të paktën 25%.

Të jetë e pajisur me sistem monitorimi aktiv për aplikimin ‘low-flow’ dhe identifikimin e miksimëve të tipit ‘hypoxic’, duke synuar konsumin minimal të agjentëve anestezike.

Të jetë i pajisur me të paktën 2 (dy) pozicione për instalimin e 2 (dy) vaporizatorëve.

Të ofrojë mundësinë e instalimit të paktën të vaporizatorëve Sevoflurane, Isoflurane.

Të paraqesë matje dhe vlera numerike në lidhje me MAC (Minimal Alveolar Concentration).

Paraqitja grafike të mundësujë të paktën 4 (katër) forma valore dhe të ofrojë mundësi konfigurimi nga ana e përdoruesit.

Paneli i punës të jetë me sipërfaqe prej të paktën 1000 cm².

Në konfigurim të përfshihen modalitetet e ventilimit: qark i hapur/ACGO, VC, PC, PRVC, SIMV-VC, Ventilim kardiak (bypass), CPAP/PSV.

Të shoqërohet me kanistrën absorbuese CO₂ e cila mund të zëvendësohet përgjatë punës pa ndërprerë ventilimin ndaj pacientit.

Ventilim manual me valvol sigurie të rregullueshme deri në max 70 cm H₂O.

Karakteristikat e ventilimit:

Rrjedhja e gazit të përfshijë rangjet nga 1 – 100 Litra/min.

Volumi tidal të përfshijë rangjet nga 5 deri në 1500 ml.

Rangu respirator të përfshijë vlerat nga 4 – 100 frymëmarrje / min.

Raporti I/E të përfshijë intervalin nga 1:8 deri në 2:1.

PEEP OFF, ON 4 deri në 30 cm H₂O.

Presioni inspirator të përfshijë rangun nga 5 deri max në 70 cm H₂O.

Valvola e emergjencës APL në ventilimin manual : të jetë max 70 cm H₂O.

Alarmi për presionin e lartë të përfshijë intervalet 12 deri në 100 cm H₂O.

Volumi për minutë 0.5 deri në 100 litra/min. $\pm 1\%$

Alarmi APNEA: 30 s.

Të ofrojë matje në kohë reale të përqendrimit të oksigjenit ku të përfshihen vlerat në intervalin nga 0 deri në 100%, N₂O, CO₂ në vlerat nga 0 deri në 15%.

Të dedektojë dhe të paraqesë alarme në rastin e rrjedhjes apo humbjes së gazit në qarkun e pacientit.

Furnizimi me energji elektrike në 220 - 240 VAC 50/60 Hz.

Të shoqërohet me bateri të rikarikueshme për një aplikim autonom prej të paktën 90 minutave në rastin e shkëputjes së energjisë elektrike.

Të shoqërohet me të paktën 1 (një) set komplet të ripërdorshëm në lidhje me qarkun e frymëmarrjes

së pacientit adult për ventilim automatik dhe manual.

2 Respirator

Respirator me funksione të avancuara për mbrojtjen e mushkërive për pacientë adult dhe pediatrikë.

Të ofrojë teknologji me sistem respirimi pneumatik, me besueshmëri dhe jetëgjatësi të lartë, me zhurmë të ulët, pa njësi motorrike të konsumueshme (turbinë).

Të jetë e pajisur me karrel me 4 (katër) rrota ku të paktën 2 (dy) prej tyre të jenë me mekanizëm frenimi.

Të ketë ndërfaqe kontrolli me ekran me prekje (touch screen) me dimension të paktën 15”.

Të jetë e pajisur me modul për monitorimin e oksigjenit.

Furnizimi me gaze mjekësore ajër dhe oksigjen në intervalin e përafërt të presionit në intervalin nga 3 deri në 6 atm.

Të ketë sistem elektronik i përzierjes së gazeve për të garantuar FiO₂ në intervalin e plotë nga 21 deri në 100% O₂.

Të ketë alarm zanor dhe vizual për volumin tidal, volumin minutë, FiO₂, presionin, APNEA, etj.

Të ketë portë inspirimi me filtër anti-mikrobial dhe me mundësi gjenerimi fluksi të pacientit në intervalin nga 1 deri në 180 L/min

Të ketë portë ekspirimi e pajisur me valvol aktive respirimi me sensor fluksi dhe me enë për mbledhjen e lagështisë.

Të jetë i pajisur me sistem ngrohës elektrik për valvolën e ekspirimit/ ose të shoqërohet me elementët e nevojshëm për uljen e kondesimit në qarkun e pacientit.

Të mundësojë identifikim automatik të lidhjes së pacientit me respiratorin.

Të mundësojë regjistrimin e trendeve deri në jo më pak se 48 orw.

Të ofrojë paraqitje simultane për të paktën 4 (katër) forma valore: Fluks, Presion, kurba CO₂ dhe të paktën një kurbë spirometrie.

Të mundësojë kompensim elektronik deri në 100% për tubat endotracheale dhe kanjulat e trakostomisë.

Të mundësojë kompensim të humbjeve në qark dhe të trigerit të fluksit.

Të përfshihen modalitetet e Respirimit:

- Kontroll Volumi,
- Kontroll presioni,
- Respirim i Sinkronizuar me pacientin SIMV me kontroll Volumi dhe kontroll Presioni,
- Respirim me dy nivele presioni,
- Respirim me dy nivele presioni me garanci Volumi ose Volume Control ose ekuivalent,
- Respirim jo-invaziv (NIV),
- Modalitet CPAP,
- Modalitet me lëshim presioni APRV,
- Modalitet me mbështetje Volumi.

Të ofrojë matjet spirometrike për parametrat:

- Presion mesatar,
- Presion maksimal,
- Plateau, PEEP inspirim/ekspirim,
- Volumi Tidal inspirim/ekspirim,

- Raporti Inspirim/Expirim,
- Volumi Minutë inspirim/ekspirim,
- komplanca dhe rezistenca.

Të përfshihen funksionet “Rapid Shallow breathing” RSB dhe Forca Inspiratore Negative (NIF)

Të ofrojë presionin e bllokimit P 0.1 dhe presionin e brendshëm PEEP

Të përfshihet funksion i avancuar për testimin e kapacitetit respirator spontantë pacientit me kohë të rregullueshme.

Të përfshihet paketë e avancuar llogaritjesh pulmonare për:

- presionin e pjesshëm alveolar të oksigjenit,
- indeksin e oksigjenimit,
- raportin e saturimit dhe fraksionit të oksigjenit të inspiruar,
- volumi i hapësirës së vdekur,
- ventilimi alveolar.

Saktësia e kontrollit të perzierjes Ajer/O₂ të ofrohet : ± 5% ose më mirë

Presioni inspirator i rregullueshëm të jetë të paktën në rangun nga 1 deri në 95 mbar.

Volumi tidal të jetë: afërsisht në rangun 30÷1500 mL ose më mirë.

Raport I/E i ndryshueshëm të jetë afërsisht nga 1:8 deri në 4:1 ose më mirë.

PEEP i rregullueshëm të jetë: afërsisht në rangun 4÷50 mbar ose më mirë

Frekuenca respiratore e rregullueshme në intervalin 4 deri në 100bpm

Trigger Fluksi të jetë në rangun nga 1 deri në 8 Litra/min.

Të mundësohet kryerja e procedurës së dedikuar për aspirim me kateter të mbyllur në rastet e pacienteve të infektuar me patogjenë.

Të ofrojë procedurë të dedikuar për aspirimin e pacienteve:

- Preoksigjenimi të mundësohet maksimumi 120 sekonda
- Pas Oksigjenim të mundësohet: maksimumi 120 sekonda
- Faza e thithjes të mundësohet maksimumi 120 sekonda

Të ofrojë funksion inspirimi manual me aktivizim nga operatori.

Të përfshihet nebulizator me kontroll të sinkronizuar të shpërndarjes së gazit në fluksin inspirues.

Të jetë e pajisur me nebulizim e aktivizuar në sinkronizim me inspirimin.

Kohëzgjatja e nebulizimit të jetë të paktën deri në 30 min.

Të ofrojë procedurë për matjen automatike të PEEP tek pacienti i lidhur me respiratorin.

Furnizimi me energji të jetë 220 deri në 240 V/50Hz dhe i pajisur me bateritë integruar për të paktën 30 minuta autonomi në rastin e ndërprerjes së energjisë elektrike.

Të jetë e pajisur me suport të artikulluar për fiksimin e qarkut të respirimit në afërsi të pacientit.

Të jete i pajisur me portë USB.

Të jetë i pajisur me ekran LCD me prekje (touchscreen) dhe me përmasë të paktën 15".

Të mundësojë kontroll dinamik të temperaturës dhe lageshtisë.

Të ofrojë modalitet Invazive me ngrohjen në intervalin e temperaturës në rangjet nga 35 deri në 40°C ±1°C

Të mundësojë modalitet Jo-Invazive me ngrohje në intervalin e temperaturës në rangjet nga 30 deri në 37°C ±1°C.

Të jetë i përshtatshëm për qark respirator me një ngrohës dhe dy ngrohës.

Të mundësojë sistem mbrojtje ndaj temperaturave të larta.

Furnizimi me energji elektrike në 220 - 240 VAC 50/60 Hz.

Të shoqërohet me 10 (dhjetë) sete respiratore me një përdorim adulte me ngrohje dhe 10 (dhjetë) sete respiratorë me një përdorim pediatrik me ngrohje (depozitë uji + qark respirator).

3 Grafi-skopi stacionare digjitale

Aparat grafi – skopi i montuar në dysheme me sistem i integruar imazherik grafi-skopi digjital. Sistemi duhet të shoqërohet me UPS për të garantuar autonomi prej të paktën 10 min në rastin e ndërprerjes së energjisë elektrike. Nuk do të pranohen sisteme analogë me mekanizma konvertimi drejt ‘output-it’ digjital. Sistemi duhet të përmbajë:

Gjeneratorin e rrezeve X:

Të jetë me kapacitet në jo më pak se 50 kW.

Të jetë i aplikueshëm për radiografi dhe fluoroskopi (të vazhdueshme dhe të pulsuar).

Të mundësohet ekspozimi manual me të paktën 2/3 faktorë (kV, mAs dhe Sek).

Të mundësohet ekspozimi automatik me të paktën 1/2 faktorë (kV dhe mAs).

Të synohet performancë e lartë, optimizim dhe cilësi në imazh nëpërmjet aplikimit të dozave të ulëta.

Të suportoje intervalet në lidhje me radiografinë nga të paktën 40-150 kV, 10-800 mA dhe 0,001-5 sekonda ose më mirë për secilin rang aplikues.

Të suportoje intervalet në lidhje me fluoroskopinë në të paktën 40-125 kV dhe 0,5 – 10 mA ose më mirë për secilin rang aplikues.

Kapacitetet kv dhe mA të mund të rregullohen në mënyrë të automatizuar.

Tubin e rrezeve X:

Të ketë 2 (dy) spote fokale.

Kapaciteti i nxehtësisë në lidhje me anodën duhet të përballojë të paktën vlerën: 500 kHU

Kapaciteti maksimal i ekspozimit në kV të jetë afërsisht 500kV.

Të ketë sensorë për mbrojtje ndaj efektit ‘collision’ (fërkim) si dhe mbrojtje nga mbinxehja.

Kolimatorin:

Të suportoje aplikimin automatic dhe të motorizuar.

Të ketë tregues me dritë LED.

Përzgjedhja e filtrave shtesë të mund të bëhet në mënyrë të motorizuar, automatike apo edhe manual.

Tavolinë radiografie:

Të montohet në dysheme për të siguruar qendrueshmëri më të mirë.

Të mund të komandohet me panel komandimi të integruar / pedale (footswitch) si dhe të mund të komandohet në anën e operatorit / panelit të komandimit drejt lëvizjeve të motorizuara.

Të ketë material rezistent ndaj efektit ‘collision’ / gërryerje si dhe të mund të pastrohet me lehtësi. Shtrati duhet të ketë të integruar stativin (‘bucky’ unit) për të realizuar radiografi dhe fluorosopi (ekzaminime toraksi dhe abdomen).

Të përballojë të paktën peshën prej 200 kg në lidhje me pacientin.

Përmasat e shtratit të jenë afërsisht 200 x 70 cm ose më mirë.

Të mundësojë lëvizje vertikale prej +90 gradë si dhe lëvizje trendelenburg me 15 gradë.

Të shoqërohet me aksesore si mbështetëset e shpatullave, mbështetëset për duar, mbështetëse për këmbë si dhe rripa për pacientin.

Sipërfaqja e sipërme e tavolinës të jetë e lëvizshme (nga paneli i komandimit) në të katër drejtimet për një pozicionim të pacientit.

Detektori digjital:

Të jetë i tipit flat panel digjital.

Të garantojë cilësi të lartë në radiografi dhe fluoroskopi.

Madhësia e detektorit të jetë të paktën: 40cm x 40 cm.

Matrica e imazhit të jetë të paktën 2000 x 2000 piksela.

Madhësia e pixelit duhet të jetë afërsisht 140µm ose më mirë.

Të suportojë të paktën 30 fps (frame për sekondë) ose më mirë.

Panelin e kontrollit:

Njësia kompjuterike 'workstation' të ofrojë processor me kapacitet të fuqishëm (intel xeon ose më mirë), kapaciteti RAM të jetë jo më pak se 16 GB dhe të ketë SSD me të paktën 1 TB.

Të shoqërohet me 2 (dy) monitorë radiologjikë me përmasa të paktën 19".

Të paraqesë vlerat e rrezatimit (dozës) në monitorë

Të mundësojë pozicionimin e shtratit / pacientit

Të aplikojë parametrat rrezatues

Programet / aplikacionet pra komponenti software duhet të jetë me licencë pa afat.

Të suportojë paketën e plotë DICOM si dhe të mund të lidhet në rrjetin spitalor si dhe PACS-e

Të ketë ndërfaqe USB, HDMI / VGA, etj

Të mundësojë ruajtjen, përpunimin, rishikimin e imazheve si dhe manaxhimin e të dhënave të pacientëve

Të mundësojë eksportimin e media nëpërmjet USB, ose DVD, etj

Të ketë veshje plumbi për mjekun / operatorin

Printeri:

Të jetë i tipit 'dry Printer' me teknologji Laser

Të ketë rezolucion minimal 300 dpi ose më mirë

Të ketë kapacitet printimi: min 70 filma/orë për madhësinë e formatit 35cm x 43cm

Formatet e disponueshme të printimit të jenë 35x43cm; 26x36cm dhe 20x25cm

Të shoqërohet me të paktën 500 filma për çdo format printimi të kërkuar

4 Echo 3D/4D me aplikim të përgjithshëm + sondë lineare + sondë kardiake + sondë konvekse + sondë gjinekologjike

Njësia imazherike Eko 3D/4D të mundësojë aplikime të përgjithshme për pacientët (Gjinekologjike, Obstetrike, Abdominale, Kardiake, Vaskulare, Urologjike, Inde te buta

Pediatrike dhe Muskuloskeletale).

Të shoqërohet me paketën ‘software’, databazën e manaxhimit të të dhënave për pacientët dhe imazhet.

Të mundësojë metodat e imazhit si 2D, 3D, 4D, M, CD - Color Doppler, PD - Power Doppler, PWD - Pulse Wave Doppler, CW – Continuous Wave, TDI – Tissue doppler imaging, etj

Të mundësojë opsionet e kombinuara si duplex dhe triplex (color-flow) në kohë reale.

Të mundësojë opsione si ‘single mode’, ‘dual’, ‘quad’, ‘simultane’ (triplex), modalitet zmadhimi, shkrim / lexim (read/write) etj

Të mund të aplikohet në disiplina të ndryshme mjekësore si kardiologji, radiologji, gjinekologji si opsione standarte me presetet e kaluara ne aparature dhe matjet përkatëse për radiologji, kardiologji dhe obstetri gjinekologji.

Të mundësojë reduktimin e zhurmave / artefakteve drejt një imazhi më të mirë.

Furnizmi me energji elektrike në 220 - 240 VAC 50/60 Hz.

Të ketë të paktën 4 (katër) porta për mundësi lidhje me sondat.

Të shoqërohet me printer monokrom termik të integruar.

Frekuenca e aparatit të mundësohet afërsisht në intervalin nga 1 deri me 15 MHz.

Të ketë thellësi imazhi në varësi të sondave dhe presetëve përafërsisht në intervalin nga 1.5 ± 0.5 cm deri në 40 ± 0.5 cm ose më mirë.

Të ketë afërsisht 8 (tetë) pika fokusi të selektueshme.

Të mundësojë të paktën një “ frame rate” në jo me pak se 1,400 fps (Hz) për një rezultat dhe imazh sa më cilësor

Të mundësojë post - procesim të imazheve në modalitete të ndryshme (psh: B-Mode, M-Mode, PW/CW, Color Doppler, 3D etj).

Të ketë kapacitete memorie brendshme/jashtme jo më pak se 1 TB ku të paktën 128GB të jetë SSD ose më mirë

Të jetë i pajisur me dalje HDMI, USB

Të shoqërohet me mekanizma (bateri e integruar / mekanizëm UPS) për autonomi në rastin e shkoputjes së energjisë elektrike të paktën për 30 min.

Të mundësojë raporte të editueshme ku mund të përfshihen imazhet dhe komentet e mjekut / operatorit si dhe të ofrojë mundësi printimi në letër me format A4.

Të ketë të përfshira matjet dhe pre setet për aplikime të përgjithshme si kardiale, abdominale, muskoseletale, gjinekologjike / obstetrike etj

Monitori i aparatit të jetë jo më pak se 21” LED me rezolucion të lartë të paktën 1.920 x 1080 pixel për një paraqitje sa më cilësore dhe të qartë të imazhit.

Të mund të lidhet në rrjetin spitalor duke suportuar mundësitë e lidhjes ‘wireless’, ethernet, DICOM etj për shkëmbimin dhe ruajtjen e të dhënave si dhe imazheve grafike

Të ketë të paktën 4 (katër) mbajtëse për sondat dhe 1 (një) për xhelin

Të jetë e pajisur me tastiere me orientim alfanumerik jo vetëm në panelin e komandimit por gjithashtu edhe në ekranin me prekje (touch screen)

Të ketë të integruar ekran me prekje (touch screen) me madhësi ekrani jo mw pak se 13” dhe me rezolucion HD ose më mirë

Të ketë opsionet si Auto EF (ejection fraction), ‘Strain’, Analize të Karotidespër “intima-media thickness”, matje automatike të IMT, skanim panoramik etj

Të mundësojë matje automatike për çdo hap të matjeve ekokardiografike si septumit interventrikular, Diametri LV, Diametriimurit posterior, Diametri LA, Diametër Aorte, Volum LA dhe LV, në planet 2 Chamber sikursedhenë planet 4 Chamber. Matje automatikenë M Mode

të Aortes, LA, LV, Spetumit, Murit posterior, Matje Automatike në doppler të Vmax dhe Velocity për valvolatmitrale, aortës, pulmonare etj

Të jetë e pajisur me opsionet për ekzaminimin Elastografik për gjirin, tiroiden, etj.

Të jetë e pajisur me opsionet për ekzaminimin Elastografik Searware tw heparit

Të jetë e pajisur me opsionet 3D/4D, Guidë për Biopsi në varwsi të sondave, EKG, Stress Echo etj

Të jetë e pajisur me opsionet për theksimin e ngjyrave

